



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16777 Prot

Lezhë, më 28.08.2026

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore", neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja "a", në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Gusht 2026)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **enjte**, në datën **03.09.2026**, në orën **11:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak (në Pallatin e Kulturës Lezhë), me këtë

REND DITE:

1. Projekt-Vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2026"
2. Projekt-Vendim "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 "Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026"
3. Projekt-Vendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 "Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026"
4. Projekt-Vendim "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 28.01.2026 "Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve e mësuesve dhe qendrave të grumbullimit"
5. Projekt-Vendim "Për emërtimin e rrugës nr. 03170053 me emrin "Zef Përdeda" në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen"
6. Projekt-Vendim "Për emërtimin e rrugës së shkollës fillore në fshatin Fishtë, Njësia Administrative Blinisht, me emrin Kardinal Ernest Troshani"
7. Informacion mbi realizimin e buxhetit për 7-mujorin e vitit 2026
8. Diskutim mbi relacionin shpjegues të dërguar nga Kuvendi "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
9. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E mërkurë	02.09.2026	09:00
2	Komisioni i Shërbimeve Publike	E mërkurë	02.09.2026	09:15
3	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E mërkurë	02.09.2026	09:30

KRYETARI
NDUE LULI

